



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

Z. Hoxha

Zy. Topca

V E N D I M

Nr. 435, datë 8.6.2016

14.06.2016

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1374,**  
**DATË 10.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,**  
**“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE,**  
**QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN**  
**E DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Emërtimi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashki”.
- b) Emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit”.
- c) Emërtimi “Drejtori Rajonale e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”.
- ç) Termi “kullotë komunale” zëvendësohet me “kullotë bashkiake”.

2. Pas shkronjës “c”, të pikës 6, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullor nga ana e kryetarit të bashkisë, brenda territorit

administrativ të të cilit është sipërfaqja kullimore e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullimor.”.

3. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, identifikimin e ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga marrja e kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.”.

4. Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Vlera e sipërfaqes kullimore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a” e “b”, të pikës 9, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullimore e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullimor.”.

5. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Kur kërkesa bëhet sipas përcaktimit në pikën 15, ajo shqyrtohet nga Ministria e Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati, ajo quhet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**NIKO PELESHI**

**MINISTRI I MJEDISIT**

**LEFTER KOKA**

NR.PROT. 3501/3  
DATE 10 6 .2016

MINISTRISË SË MJEDISIT  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË ENERGIJË DHE INDUSTRIJË  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHENIET ME  
PARLAMENTIN  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE  
AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË REFORMËS  
TERRITORIALE  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

